



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

I. LEGJISLATURA E IX DHE LIGJET ME BAZË GJINORE

Hyrje

Kuvendi i Shqipërisë edhe gjatë kësaj legjislature ka patur në vëmendje përmirësimin e kuadrit ligjor të ligjeve më bazë gjinore bazuar në objektivat e Kuvendit dhe angazhimet e marra nga shteti shqiptar në kuadër të përmbushjes së plotë të të gjithë detyrimeve si shtet palë në konventat ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi.

Arritja e barazisë gjinore si dhe minimizimi i dhunës ndaj grave e vajzave si dhe dhunës në marrëdhëniet familjare përbëjnë një prioritet të rëndësishëm, në veprimtarinë e Kuvendit, lidhur ngushtë me proceset integruese të vendit.

Kuvendi i Shqipërisë, me ligjet e miratuara ka bërë përmirësime të legjislacionit ekzistues në kuadër të përmbushjes së plotë të të gjithë detyrimeve si shtet palë i konventës CEDAW. Këto nisma ligjore në mbrojtje të grave dhe vajzave janë iniciuar si kërkesë e konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, por edhe presionit pozitiv, falë dhe ndjeshmërisë së shoqërisë civile.

Kuvendi i Shqipërisë, Aleanca e Grave Deputete, do të vazhdojë të mbështesë çdo përpjekjet për të avancuar drejt barazisë gjinore dhe tolerancës zero kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, përmirësimit të mëtejshëm të bashkërendimit me partnerët qeveritarë dhe aktorë të tjerë të interesuar, sidomos me organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në mënyrë specifike për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve në lidhje me këto çështje, vënien në dispozicion të burimeve njerëzore e financiare për sigurimin e shërbimeve të mjaftueshme e të aksesueshme si dhe ngritjen e mekanizmave monitorues efektivë e të qëndrueshëm.

Ligjet me bazë gjinore të miratuara

✓ **Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”**, solli si risi ndihmën juridike që i ofrohet viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të abuzuara seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre.

✓ **Ligji nr.35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”**. Një ndër ndryshimet është mbrojtja e viktimës, duke parashikuar disa të drejta të posaçme që lidhen me vetë cilësitë e saj të veçanta.

✓ **Ligji 70/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës”**, ku parashikohet se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, për kryerjen e veprave penale lidhur me trafikimin e të rriturve/riturave dhe të miturve/miturave. Ky ligj përcakton krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e krimit të organizuar, për të cilin përdoren si burim pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara (me vendimin e Gjykatës). Fondi i veçantë është caktuar për qëllime sociale, duke përfshirë rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të trafikimit.

✓ **Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”**, vendosi rregulla, procedura dhe modalitete administrative për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara i cili rregullohet për herë të parë nëpërmjet dispozitave të këtij projektligji parashikohet të përfitojnë shtresat vulnerabël ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje dhe vajzat nëna.

✓ **Ligji nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”** ku në nenin 3/1 theksohet që zbatimi i tij bazohet edhe në CEDAW. Ky ligj ka forcuar masat mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës, duke parashikuar mekanizmin e lëshimit të Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, si dhe duke theksuar rëndësinë e kryerjes së vlerësimit të riskut për çdo rast që trajtohet. Për herë të parë, ligji mbron gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesat ose bashkëjetesa.

Ky ligj ka pësuar ndryshime të reja: duke vendosur në ligj largimin e dhunuesit nga banesa, programet rehabilitimi për dhunuesin, kthimi në banesë me mbarimin e afatit, regjistri i urdhrave të mbrojtjes e tjerë . Ligji reflekton rekomandimet të GREVIO-s.

Përmirësimi i kuadrit ligjor në këtë ligj konsiston në:

- a. Harmonizimin e legjislacionit shqiptar dhe përmbushjen e detyrimeve dhe standardeve të vendosura nga konventa e Këshillit të Europës “*Për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*”, ratifikuar me ligjin nr.104, datë 8.11.2012 dhe në mënyrë të veçantë të rekomandimeve për Shqipërinë të Komitetit GREVIO, që vepron në kuadrin e kësaj konvente, të publikuara në muajin dhjetor 2017;

- b. Përbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Komiteti CEDAW, në kuadër të raportimit për zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, në vitin 2016;
- c. Zgjerimin e rrethit të subjekteve që përfshihen në kategorinë e pjesëtarëve të familjes duke parashikuar mbrojtje të posaçme edhe për personat që janë në lidhje afektive (intime). Ky rregullim mundëson mbrojtjen e një kategorie subjektësh që deri më tani nuk mbroheshin nga ky ligj, por vetëm nga kodi penal.
- d. Shtimin e garancive ligjore për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, në kuadër të hamonizimit të këtij projektligji me parashikimet e legjislacionit në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.
- e. Parashikimin e detyrimit të autoritetit kryesor përgjegjës për të raportuar përpara komisionit përgjegjës parlamentar/ nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës. Ky rregullim reflekton edhe standardet ndërkombëtare të parashikuara në konventat lidhur me rolin e parlamentarëve në adresimin e çështjeve gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve dhe është në përbushje të Rregullores së Kuvendit dhe angazhimeve të marra nga Kuvendi mes rezolutave të miratuara prej tij;
- f. Parashikimin e një mbrojtjeje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara në harmoni me konceptin e përshtatjes së arsyeshme, bazuar në Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe ligjin për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara;
- g. Qartësimin dhe saktësimin e kompetencave të autoritetit kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen e shërbimit në qendrën kombëtare të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje dhe për koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;
- h. Përshtatjen dhe hamonizimin e detyrave të caktuara për ministrinë përgjegjëse për drejtësinë me parashikimet e bëra në legjislacionin në fuqi për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, nëpërmjet parashikimit të bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe organe të tjera në përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje.
- i. Saktësimin e përgjegjësive dhe shmangien e mbivendosjes të detyrave të autoriteteve përgjegjëse, veçanërisht duke u mbështetur në parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në përcaktimet e ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;
- j. Parashikimin e mekanizmit të urdhrimit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme me qëllim sigurimin e balancës së duhur ndërmjet sigurimit të mbrojtjes së viktimës, respektimit të të drejtave të dhunuesit dhe shmangies së çdo mundësie për abuzim nga ana e autoriteteve policore;
- k. Dhënien e ndihmës ligjore falas, nëpërmjet avokatëve të kualifikuar **mbështetur në parashikimet e ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;**

✓ **Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”**, që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive.

✓ **Ligji nr. 111/2018 “Për kadastrën”**, që gjithashtu rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

✓ **Ligji nr.69/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”**, ku parashikohet procedura e regjistrimit për rastet e paregjistruara, kur akti i lindjes lëshuar nga një shtet tjetër ku ka ndodhur lindja, ka të dhëna të paplota dhe të pasakta.

✓ **Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”**, ku viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen tek grupet e veçanta të punëkërkues(e)ve të disavantazhuar(a) në tregun e punës, të cilët/cilat përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit.

✓ **Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”** ku përcaktohen si përfitues/përfituese të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

✓ **Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”**, ku theksohet mirëadministrimi dhe përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

✓ **Ligji nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”**, i ndryshuar, që konsiston në kriminalizimin e dhunës psikologjike si dhe zgjerimin e rrethit të subjekteve që mbrohen, duke parashikuar që edhe personat në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale të gëzojnë mbrojtjen e nevojshme, duke harmonizuar përmbajtjen e këtij neni me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet ligjore të bëra në vitin 2018 në ligjin për dhunën në familje. Gjithashtu ligji parashikon ashpërsimin e dënimeve për disa figura të kësaj veprës penale. Risitë konsistojnë në:

a) Kriminalizimin e dhunës psikologjike;

b) Zgjerimin e rrethit të subjekteve që mbrohen prej tij, duke parashikuar që edhe

personat në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale të gëzojnë mbrojtjen e nevojshme, duke harmonizuar përmbajtjen e këtij neni me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet ligjore të bëra në vitin 2018 në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar;

c) Ashpërsimin e dënimeve penale për disa figura të kësaj vepre penale.

Kodi Penal ka ndryshuar edhe në vitin 2020, duke reflektuar rekomandimin e GREVIO-s për dhunën psikologjike.

Kuvendi, me përmirësimin e këtij kuadri ligjor përmbushi detyrimet që rrjedhin nga Raporti GREVIO-s mbi zbatimin e Konventës së Stambollit në Shqipëri, i bërë publik në Dhjetor 2017, ku argumentohet se neni 33 i Konventës së Stambollit, kërkon që palët të kriminalizojnë dhunën psikologjike, e cila përshkruhet si sjellje me dashje për të dëmtuar rëndë integritetin psikologjik të një personi me anë të shtrëngimit ose kërcënimeve

✓ **Ligji nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të Huajt”**, ku parashikohet mbrojtje më e mirë për viktimat e huaja të trafikimit.

✓ **Ligji nr. 59/2020 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet RSH dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për politikën për zhvillim për aksesin e barabartë gjinor në mundësitë ekonomike”**, që ka për objekt mbështetjen e qeverisë shqiptare për të përmirësuar kuadrin e politikave për akses të barabartë gjinor në mundësitë ekonomike, duke u përqendruar te: rritja e aksesit të grave në pasuri; vendosja e rregullave të barabarta të lojës për rritjen e mundësive për gratë në tregun e punës; forcimi i rregullave institucionale për një politikë bërje të informuar gjinore.

✓ **Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat e trajtimit e të burgosurve”** i cili ka sjellë përmirësime në trajtimin e të burgosurve. ka disa nene për trajtimin e grave të dënuara, viktimat e dhunës në familje ose dhunës seksuale

✓ **Ligji nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.** Ky ligj garanton respektimin e parimit të barazisë gjinore, sipas përcaktimeve që i jep këtij parimi legjislativi në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe aktive në jetën politike dhe publike e gjinisë së nën përfaqësuar përbën instrument themelor në konsolidimin e sistemit demokratik. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të zbatohet ose interpretohet në kundërshtim ose në shkelje të këtij parimi.

Detyrimi për respektimin e parimit të barazisë gjinore u përket subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore dhe gjykatës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë mbi tagrat që subjektet zgjedhore kanë sipas këtij ligji, të kërkojë nga subjektet zgjedhore pushimin e cenimit të këtij parimi dhe, në rast mosveprimi, të ndërhyjë kryesisht për rivendosjen e tij.

✓ **Ligji nr. 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar** synon reduktimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare e në njësinë shtëpiake dhe mbrojtjen e veçantë e pa diskriminim të çdo grupi që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje duke parashikuar si masë me vete dhe të zbatueshme detyrimisht në çdo rast largimin e dhunuesit nga banesa.

II. VEPRIMTARI TË TJERA TË KUVENDIT ME BAZË GJINORE

Kuvendi ka miratuar strategjinë e edukimit ligjor të publikut dhe pjesë e saj janë gratë dhe vajzat dhe njohja me ligjet për barazinë gjinore dhe të tjera si dhe ka miratuar planin e veprimit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në zbatim të përmbushjes së detyrimeve, ka ratifikuar protokolle dhe marrëveshje në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave nga forma të ndryshme të diskriminimit, keqtrajtimit, të dhunës në familje, të mundësimit të barazisë gjinore në vendimmarrje. Për periudhën 2015-2020 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka ratifikuar me Ligjin nr. 122/2015 datë 12.11.2015 Protokollit nr. 15 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Gjithashtu, me Ligjin nr. 59/2020 datë 30.4.2020, Kuvendi ka ratifikuar marrëveshjen e huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për politikën për zhvillim për aksesin e barabartë gjinor në mundësitë ekonomike.

✓ **Zhvillimi i seancave publike të Komisioneve të Përherëshme të Kuvendit.**

Seancat publike kanë mundur informimin e publikut, përfshirë dhe të gratë mes medias dhe seancave dëgjimore, si dhe nga raportimet vjetore në Kuvend të Prokurorit të Përgjithshëm, të Avokatit të Popullit, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale etj.

Paraqitja e raportimeve të institucioneve kushtetuese, interpelancat, ndihmojnë jo vetëm në kontrollin parlamentar, por sensibilizojnë publikun e gjerë për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe atyre të grave në veçanti.

✓ **Miratimi i rezolutave për punën e institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj.**

Parë në këndvështrimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, bërja e rekomandimeve për përmirësimin në të ardhmen janë të rëndësishme për përmirësimin e punës së këtyre institucioneve.

✓ **Ngritja e nënkomisioneve si: Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, Nënkomisioni Për Zhvillim të Qëndrueshëm.**

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, ka organizuar seanca dëgjimore, takime dhe konferenca të ndryshme në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe Aleancën e Grave Deputete me tema referuar aktivitetit të Nënkomisionit, si aspekti gjinor, vendimmarrja, gratë në parlament, buxhetimi gjinor etj. Seanca dëgjimore në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, disa të realizuara në bashkëpunim me Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, me Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Aleancën e Grave Deputete.

✓ **Miratimi i rezolutave.**

Kuvendi i Shqipërisë duke vlerësuar maksimalisht, rëndësinë e zbatimit të detyrimeve të marra përsipër nga vendi ynë, nëpërmjet ratifikimit të Konventës së Stambollit, si dhe reflektimin dhe adresimin në legjislacionin e brendshëm të rekomandimeve përkatëse të organizmave monitoruese (Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Europës, “Mbi luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO)”), miratoi në Dhjetor të vitit 2017 Rezolutën “Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj”. Në datë 4.12.2017, Kuvendi miratoi rezolutën “Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara

✓ **Ngritja e grupimeve vullnetare si: Aleanca e Grave Deputete, Grupi Miqtë e Fëmijëve.**

Aleanca e Grave Deputete, vetë apo në bashkëpunim me Komisionet e Përhershme të Kuvendit, me Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas ka zhvilluar aktivitete të ndryshme si: *workshop*-e, pjesëmarrje në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, pjesëmarrje në aktivitete sensibilizuese, si dhe ka luajtur një rol aktiv në përmirësimin e ligjeve me ndjeshmëri gjinore, të cilat miratohen në Kuvend për t'i përshtatur ato me standardet më të mira ndërkombëtare, ku pjese e së cilët janë dhe rekomandimet e Konventës së OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW)”

✓ **Rritja e përfaqësimit të grave në parlament dhe në organet e tij.**

Kuvendi i Shqipërisë, në vijimësi ka vlerësuar dhe ka pasur në fokusin e tij, përfshirjen gjithnjë në rritje të përfaqësimit të gruas në Parlament, në organet më të larta qeverisëse përfshirë organet kushtetuese e të krijuara me ligj dhe ato gjyqësore. Kjo pasi prezenca e shtuar e gruas në këto struktura është vlerësuar se ka ndikuar dhe ndikon ndjeshëm në përmirësimin e klimës politike, në

rritjen e nivelit të qytetarisë, ndjeshmërisë dhe përgjegjshmërisë. Gjithashtu Kuvendi ka pasur në vëmendje faktin se çështjet e barazisë gjinore janë në fokus të vazhdueshëm të politikave sociale edhe të vetë vendeve të Bashkimit Evropian (BE) dhe përbëjnë gjithashtu një kriter avantazhues në procesin e integritit dhe anëtarësimit evropian.

Në këtë legjislaturë, Kuvendi i Shqipërisë, numëron **41 (dyzet e një) gra deputete**, duke arritur numrin më të lartë të grave krahasuar me legjislaturat e mëparshme. Në organet e Kuvendit, drejtuese janë gratë deputete si: nënkryetarja e Kuvendit është grua. Tre Komisione të Përhershme dhe 3 nënkomisioni drejtohen nga gratë deputete.

Në përfaqësimet në organizatat ndërkombëtare dhe delegacionet e përhershme 30% janë gra. Kryetarja e Delegacionit të përhershëm parlamentar në Asamblenë Parlamentare të Atlantikut Verior (NATO) është grua.

✓ **Përfaqësimi i grave në organet Kushtetuese dhe të krijuara me ligj si dhe në shërbimin gjyqësor, në kuadër të funksionit emërues të Kuvendit.**

Roli i Kuvendit në kuadër të rritjes së nivelit të përfaqësimit të gruas dhe barazisë ligjore, nuk ka përfunduar dhe nuk është mjaftuar vetëm në përfaqësimin parlamentar. Roli i Kuvendit në këtë aspekt është shtrirë edhe në emërimet e grave, në pozicionet drejtuese apo edhe si anëtare, në organet Kushtetuese dhe të krijuara me ligj si dhe në shërbimin gjyqësor, në kuadër të funksionit emërues të Kuvendit.

Kështu Kuvendi për periudhën 2016- 2018, ka emëruar në krye të disa Institucioneve Kushtetuese drejtuese gra si: i) Avokati i Popullit (grua) - vendimi Kuvendit nr. 70/2017, datë 22.05.2017; ii) Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, pranë Avokatit të Popullit (grua) - vendimi Kuvendit nr. 41/2018, 15.3.2018; iii) Komisioneri Mekanizmi për Parandalimin e Torturës, pranë Avokatit të Popullit (grua) - vendimi Kuvendit nr. 43/2018 datë 15.3.2018 ; iv) Kryetarja e Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit (AIDSSH).

Në miratimin e përbërjes së bordeve apo komisioneve është kushtuar vëmendje që në zgjedhjen e kandidatave, pjesë përbërëse të tyre të jenë gra. Kuvendi ka bërë 41 emëime, 23 prej të cilave janë gra.

Edhe në emërimet në strukturat e reja që u krijuan në kuadër të reformës në drejtësi Kuvendi ka pasur në vëmendje ruajtjen e kuotave gjinore në këto struktura .

Përgatiti: Drejtori i Shërbimit Juridik në bashkëpunim me Aleancën e Grave Deputete